



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.Anr.44/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët Violeta Husaj Rugova kryesuese, Bujar Muzaqi dhe Hajriz Hoti anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e organizatës ndërkombëtare “Odbor za Kontrolu i Obzervaciju” - OKO , paraqitur kundër Vendimin të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me nr.protokolli 01/4121/2025 i datës 23.12.2025 nga Zyra për Regjistrim, Verifikim dhe Kontroll Financiar të Subjekteve Politike, me të cilin u refuzua kërkesa për akreditim të vëzhguesve për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datën 28 Dhjetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 26.12.2025, merr këtë:

V E N D I M

I.APROVOHET e bazuar ankesa e organizatës ndërkombëtare “Odbor za Kontrolu i Obzervaciju” - OKO e paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me nr. protokoli 01/4121-2025, i datës 23.12.2025.

II. ANULOHET Vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me nr. protokoli 01/4121-2025, i datës 23.12.2025, dhe lënda i kthehet Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) në rishqyrtim dhe në rivendosje.

A r s y e t i m

Me datë 25.12.2025 PZAP-i ka pranuar ankesën e parashtruar nga OJQ “Odbor za Kontrolu i Obzervaciju” - OKO e cila pretendon se pavarësisht faktit që e kanë paraqitur në kohën e duhur kërkesën për akreditim dhe pavarësisht faktit se nga KQZ përmes email-it më 23.12.2025 në orën 09:59 janë njoftuar se kërkesa për akreditim është miratuar nga KQZ, dhe se mund të marrin kartën e identitetit për monitorim, më vonë, të njëjtën ditë në orën 14:40, janë njoftuar përsëri se kërkesa për akreditim është refuzuar. Tutje, parashtruesi i ankesës thekson se duke qenë se edhe më parë kanë pasur një problem të natyrës teknike (gjatë akreditimit për zgjedhjet e 12.10.2025 kur morën akreditimin) me aplikacionin në faqen e internetit, supozojnë se edhe kësaj here është fjala për një dështim teknik ose sërish gabim gjatë ngarkimit të dokumenteve. Organizata OKO

(Odbor za Kontrolu i Obzervaciju) ka marrë me sukses akreditime nga KQZ edhe më parë, konkretisht për vëzhgimin e zgjedhjeve vendore në Kosovë, të mbajtura më 12 tetor 2025.

Si prova, parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur në ankesë Vendimin e KQZ-së për akreditimin, datë 01.10.2025, statutin e organizatës, dëshminë e kryerjes së regjistrimit, arsyetimin, vendimin për miratimin e regjistrimit (në formën në të cilën është lëshuar nga institucioni kompetent) si dhe pamjet e ekranit (screenshot) të aplikacionit ku është konfirmuar akreditimi dhe të korrespondencës me KQZ-në ku na është konfirmuar akreditimi dhe ku jemi ftuar për marrjen e kartave të identitetit. Informacione shtesë, si dhe verifikimin e vlefshmërisë së dokumentacionit të përmendur, mund të kontrollohen edhe përmes bazës zyrtare në adresën e mëposhtme: <https://pretraga.apr.gov.rs/detail>.

Në përgjigjen në ankesë të dërguar nga KQZ, sqarohet që sipas planit kohor të aktiviteteve për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, periodha e aplikimit për akreditim të vëzhguesve ka përfunduar me datën 20.12.2025. Organizatat vëzhguese dhe vëzhguesit e tyre, me qëllim të akreditim, duhet t'i plotësojnë kriteret ligjore si në vijim: Secila organizatë vëzhguese për tu akredituar në zgjedhje, duhet të aplikojë, duke dorëzuar listën e vëzhguesve, siç përcaktohet në par.1 të nenit 3 të Rregullores Zgjedhore nr. 08/2024- Vëzhguesit e Zgjedhjeve. Sipas par.1 të nenit 54 të LZP-së, subjektet politike të certifikuara, OJQ dhe organizatat qeveritare e ndërqeveritare, sikurse edhe organizatat ndërkombëtare të specializuara të cilat merren me zgjedhjet dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, përfaqësuesit e vendeve të huaja, kanë të drejtë të kërkojnë akreditim të vëzhguesve për zgjedhje, sipas par.1 të nenit 55 të LZP-së, të gjithë vëzhguesit e akredituar, përveç atyre të emëruar nga ndonjë organizatë ndërqeveritare, qeveri e huaj ose OJQ jo të regjistruar në Kosovë, janë persona të regjistruar për votim në zgjedhje si dhe sipas paragrafit 2 të nenit 55 të LZP-së, asnjë person nuk mund të shërbej si vëzhgues zgjedhor, nëse është kandidat për post zgjedhor në Kosovë ose pjesëtar i policisë, ushtarak ose i njësitit të inteligjencës së Kosovës ose i një shteti tjetër.

Tutje, në përgjigje, KQZ shton se organizata ndërkombëtare "Odbor za Kontrolu i Obzervaciju"- OKO, ka aplikuar për tu akredituar me qëllim të vëzhgimit të Zgjedhjeve të Parakohshme. Zyra për Regjistrim, Certifikim dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike gjatë vlerësimit të dokumentacionit, konstaton se njëri nga dokumentet e ofruara edhe pse ka vulën dhe nënshkrimin, nuk dëshmon se nga cili institucion është lëshuar, me çka e bënë të dyshimtë vërtetësinë e këtij dokumenti, i cili poashtu, nuk është dokument i plotë (ka mungesë të faqeve). Nisur nga vlerësimi i bërë, Zyra i ka rekomanduar KQZ, refuzimin e kërkesës për akreditim të "Odbor za Kontrolu i Obzervaciju"- OKO për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të cilat do të mbahen me 28 dhjetor 2025. Në takimin e KQZ të mbajtur me 23 Dhjetor 2025, Zyra ka prezantuar këtë rekomandim i cili mori votat e nevojshme për tu aprovuar dhe rrjedhimisht u refuzua aplikimi për akreditim i "Odbor za Kontrolu i Obzervaciju"- OKO.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës - PZAP-i, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe pas administrimit të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë të KQZ, gjeti se:

- Ankesa është e bazuar

Paneli vlerëson se në bazë të shkresave të lëndës rezulton se organizata ndërkombëtare “Odbor za Kontrolu i Obzervaciju”- OKO, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës që do të mbahen me datë 28 Dhjetor 2025, ka përfunduar aplikimin për akreditim për vëzhgues në kohën e duhur si organizatë ndërkombëtare në Zyrën për Regjistrim, Certifikimin dhe Kontrollin Financiar të subjekteve politike në KQZ.

KQZ-ja, në mbledhjen e mbajtur me datë 23.12.2025, ka marr vendim me numër me nr. protokolli 01/4121-2025, me të cilin ka refuzuar akreditimin me arsyetim se organizata ndërkombëtare “Odbor za Kontrolu i Obzervaciju”- OKO gjatë vlerësimit të dokumentacionit nga Zyra për Regjistrim, Certifikimin dhe Kontrollin Financiar të subjekteve politike, konstaton se njëri nga dokumentet e ofruara edhe pse ka vulën dhe nënshkrimin, nuk dëshmon se nga cili institucion është lëshuar, me çka e bënë të dyshimtë vërtetësinë e këtij dokumenti, i cili poashtu, nuk është dokument i plotë (ka mungesë të faqeve).

Ankesë kundër këtij vendimi ka paraqitur organizata ndërkombëtare “Odbor za Kontrolu i Obzervaciju”- OKO e cila kundërshton mos akreditimin si vëzhgues për zgjedhjet e parakohshme, me vlerësim se vet KQZ ka pranuar se i ka plotësuar kushtet për akreditim, ashtu siç është përcaktuar me nenit 47,48 dhe 49 të Ligjit Për Zgjedhjet.

Paneli, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, qëndrimin dhe përfundimin e KQZ-së, të përshkruar si në vendimin e tij të datës 23.12.2025 me numër protokolli 01/4121/2025, vlerëson se përfundimin e KQZ në këtë vendim nuk mund ta pranoj si të drejtë dhe të ligjshëm, nga arsyet në vijim.

Paneli vlerëson se vendimi i atakuar është i paqartë dhe në kundërshtim me vetveten, kjo pasi që KQZ në njërin anë në arsyetim të vendimit konstaton se fillimisht organizata ndërkombëtare “Odbor za Kontrolu i Obzervaciju”- OKO ka plotësuar kushtet për akreditim dhe si të tillë KQZ-ja aprovon fillimisht kërkesën për akreditim dhe po në të njëjtën ditë, më vonë kërkesa për akreditim refuzohet. Organizata në fjalë ka kërkuar të jetë vëzhgues në zgjedhjet e parakohshme, andaj KQZ ka për obligim që aplikimin ta vlerësoj në pikëpamje të kritereve të përcaktuara për akreditim dhe dispozitave ligjore që e rregullojnë këtë çështje. Nga arsyetimi i vendimit nuk rezulton se ka ndonjë arsye për faktet vendimtare të çështjes, që kanë të bëjnë me të drejtën për të qenë vëzhgues të zgjedhjeve.

Paneli i ka vlerësuar arsyet e vendimit dhe në përgjigje në ankesë KQZ thekson se Organizata Ndërkombëtare ndërkombëtare “Odbor za Kontrolu i Obzervaciju”- OKO ka aplikuar për tu akredituar me qëllim të vëzhgimit të Zgjedhjeve të Parakohshme. Zyra për Regjistrim, Certifikim dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike gjatë vlerësimit të dokumentacionit, konstaton se njëri nga dokumentet e ofruara edhe pse ka vulën dhe nënshkrimin, nuk dëshmon se nga cili

institucion është lëshuar, me çka e bënë të dyshimtë vërtetësinë e këtij dokumenti, i cili poashtu, nuk është dokument i plotë (ka mungesë të faqeve). Pra lidhur me këtë nuk mund të kuptohet për cilin dokument bëhet fjalë, pra cili dokument është dashur të jetë në rregull e që dyshohet në vërtetësinë e tij. Andaj akti administrativ është nxjerr në kundërshtim me dispozitat e neneve 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nga të cilat rrjedh detyrimi i organit që në aktin administrativ të paraqes arsye të qarta dhe të plota lidhur me faktet vendimtare të çështjes.

Nga të lartcekurat KQZ nuk ka dhënë arsye për refuzim të akreditimit dhe njëherit as në përgjigje në ankesën e palës ankuese nuk ka dhënë arsye për të qartësuar arsyen e refuzimit. Pala ankuese ka të drejtë që nga organi kompetent të marrë përgjigje të arsyetuar për rastin e tij, përkatësisht për refuzimin e akreditimit, në mënyrë që ti behët e ditur arsyeja e refuzimit, e cila e drejtë buron nga neni 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ndërlidhur me nenin 6 të KEDNJ.

Nga këto arsye, Paneli ka kthyer rastin në rivendosje në KQZ, në mënyrë që KQZ ta vlerësoj kërkesën për akreditim sipas kritereve të përcaktuara dhe dispozitat ligjore që rregullojnë këtë çështje.

Paneli vlerëson se nga dispozitat e lartcekura, rezulton se vendimi i atakuar është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi për çka vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, dhe urdhëroi KQZ-në që të rishqyrtoj vendimin sipas nenit 118 par.5 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe dispozitave nga neni 13 par. 11 të Rregullores nr.01-2025 Për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZP.Anr.44/2025, datë 26.12.2025

Kryesuese e Panelit
Violeta Husaj Rugova



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.